



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli: 5871/2025

A.nr.1323/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi–Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Sabile Avdyli-në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 1323/2025 të datës 09.07.2025 e parashtruar nga ankuesja D.G, kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 01.09.2025, me shumicë votash mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr. 1323/2025 e datës 09.07.2025 e parashtruar nga ankuesja D.G.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, D.G, (tutje referuar vetëm Ankuesja), më datë 09.07.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4587/2025, e regjistruar nën shenjen A. Nr.1323/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Pejës me pretendimin ankimor se jam e sistemuar në pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile me përgatitje profesionale drejtimi Administratë Publike dhe se Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar katalogun e punës përmes të cilit katalogë pozita Zyrtar i Gjendjes Civile, është klasifikuar në kategorinë profesional 2, me klasën ekuivalencës së pagës 4.9, sipas numrit rendor 1118, me tej ankuesja ka pretenduar nga Këshilli që të aprovohet ankesa e ankuesit si e bazuar, dhe të obligohet Komuna Pejës të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e Akt emërimit të datës 23.08.2024, sipas klasës së pagës 4.9, kategoria profesional 2 të paraparë me Katalogun e Vendeve të Punës i miratuar me datë 13.03.2011.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.07.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, ndërsa Këshilli më datën 29.07.2025, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Pejës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4587/2025 të datës 09.07.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi i datës 13.03.2011, për ankuesen; Përgjigjen e Komunës së Pejës, Përgjigjen e NJMBNJ të Komunës së Pejës dhënë ankueses datë 25.06.2025 .

Këshilli nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesja, konstatoi se ankesa është e parakohshme, sepse:

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli Nr. 02-112-182 , të datës 16.03.2011, është e punësuar në Komunën e Pejës, dhe se e njëjta mbanë pozitën e punës Zyrtare për Pranimin e Aplikacioneve dhe Lëshuarjen e Çertifikatave/ Drejtoria për Administratë . Më datë 09.07.2025 ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore sikur se janë përshkruar në hyrje të këtij arsytimi..

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor,* Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pejës, deri në parashtrimin e ankesës nga ana e ankueses nuk e kishte përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë dhe duke qenë se nuk kishte përfunduar klasifikimin e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, rrjedhimisht me nenin 34 të kësaj rregullore përcaktohet se: *Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje,* dhe po ashtu, edhe me Vendimin me Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, më pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: *Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë Klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për*

Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog, ndërsa, më pikën 3 është shfuqizuar pika 3 dhe 4, e Vendimit Nr. 04/128, të datës 16 shkurt 2023 të Qeverisë së Kosovës, pika këto që i referoheshin detyrimit të Ministrisë së Financave/Thesarit të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për ekuivalentim të koeficienteve dhe korrigjimeve.

Mirëpo duke marr parasysh faktin se sipas përgjigjes së organit punëdhënës të Burimeve Njerëzore të, kjo komunë është në fazën e miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, rrjedhimisht duke qenë së organi përkatës i punësimit në këtë rast Komuna e Pejës, është në fazën e procesit të klasifikimit të vendeve të punës në administratën komunale e që nënkupton edhe klasifikimin edhe të pozitës së ankuesit, atëherë Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja, për klasifikimin e pozitës së tij sipas kategorisë profesionale 2, është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e për rrjedhojë, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës se theksuar më lart, ankueses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 1323/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, D.G;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së